



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

**I. Numër: 463/01-29981, dt. 29 Maj 2026**

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 të nenëve 5,6,8 dhe 14 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënjën në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës neni 4, neni 5 paragrafi 1.2, neni 6 dhe neni 8 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.d.30. shtator 2020, Vendimit Nr. 08/2026 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, me nr. prot: 400/01-8274, dt: 26 Shkurt 2026, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - *Parcela Komunale nr. 302-3, fshati Novosellë me sipërfaqe 1012m<sup>2</sup> ZK Novosellë*, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date: dt. 29 Maj 2026, nxjerr këtë:

**VENDIM  
Nr. 29/2026**

**Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale me numër 302-3 në sipërfaqe prej 1012 m<sup>2</sup> ZK Novosellë**

**I. Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale nr. 302-3, pronë komunale, fshati Novosellë me sipërfaqe prej 1012m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale në Novosellë - me qëllim të rivitalizimit të objektit, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve sipas Vendimit Nr.08/2026 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, me numër të protokollit 400/01-8274, të datës 26 Shkurt 2026.

| Nr. | PRONARI<br>Poseduesi | Nr. i<br>Ngastrës | Emri i rrugës<br>(lokacioni) | Sipërfaqja         | Zona<br>Kadastrale | Destinimi                  | Periudha |
|-----|----------------------|-------------------|------------------------------|--------------------|--------------------|----------------------------|----------|
| 1.  | Komuna<br>Pejë       | 302-3             | Fsh. Novosellë               | 1012m <sup>2</sup> | ZK<br>Novosellë    | Rivitalizimi i<br>objektit | 15 vite  |

**II.** Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni komunal për vlerësimin e ofertave do të inicoj procedurën e tenderimit – ankandit publik, për zgjedhjen e ofertës më të favorshme për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale - *Parcela Komunale nr. 302-3 fshati Novosellë me sipërfaqe prej 1012m<sup>2</sup> në Zonën Kadastrale në Novosellë*, me qëllim të rivitalizimit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtëshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Komisioni Vlerësues, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.

IV. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

**Vendimi ti dërgohet:**

MAPL-së,  
Kryetarit të Komunës,  
DÇPJ,  
Arkiv.

